

RAPORT JO TEKNIK

PER DEGJESE PUBLIKE

Per ndryshim kushtesh ne lejen e mjedisit
Tpi A me PN-7777-12-2018

Subjekti: PURA-MEDICAL SHPK

NIPT: L71515507M

Erion Shalcaj
PURA - MEDICAL
Sh.p.k.
NUIS: L 71515507 M

➤ Hyrje

Ne zonen ku do te zhvillohet ky projekt nuk ka shtepi banimi, shkolla dhe aktivitete te tjera social kulturore, qe mund te demtohen nga zhvillimi i ketij projekti nga subjekti. Aktiviteti do te zhvillohet ne nje siperfaqe te sheshte. Siperfaqja e objektit ku do te instalohet trajtimi i mbetjeve eshte 148 m² dhe siperfaqja e marre ne shfrytezim me kontrate huaperdorje eshte 704 m². Subjekti ka per qellim te identifikoj efektet e mundshme ne mjedis gjate funksionimit te impianteve te autoklaves dhe incineratorit. Marrja e masave te domosdoshme per minimizimin dhe parandalimin e efekteve te krijuara ne mjedis nga aktiviteti i ketij objekti, si dhe te lihen detyra per investitorin ne sherbimin e komunitetit dhe me gjere.



Harta e vendodhjes se aktivitetit

Nr.	E	N
1	4417672.065	4551192.366
2	4417686.437	4551163.496
3	4417715.422	4551175.766
4	4417700.071	4551204.646

Kordinatat e vendodhjes se aktivitetit



Harta e vendodhjes se objektit

Nr.	E	N
1	4417682.173	4551182.448
2	4417699.480	4551189.811
3	4417702.636	4551184.174
4	4417683.511	4551172.972

Kordinatat e objektit

Ky projekt ka si qellim kryesor trajtimin me autoklave me avull dhe incinerator te mbetjeve spitalore te cilat klasifikohen si me poshte:

- 1- **Mbetje patologjike** perfshijne indet, organet, pjeset e trupit, placentat, gjakun dhe lengjet e tjera te organizmit te njeriut. Keto lloj mbetjesh trajtohen me sistem autoklave
- 2- **Instrumenta te mprehte** jane te gjitha sendet e inektuara apo te painfektuara qe mund te shkaktojne shpime apo prerje, duke perfshire dhe mos u kufizuar vetem te aget, shiringat, bisturite, tubat kapilare dhe instrumentat e tjere te mprehte.
- 3- **Mbetjet infektuese** jane te gjitha mbeturinat e ndotura nga cdo lloj patogjeni si bakterie, viruset, parazitet ose kerpudhat dhe perfshijne kulturat nga puna ne laborator, mbeturinat nga nderhyrjet kirurgjikale dhe autopsite, mbeturinat nga pacientet e infektuar si dhe materialet apo pajisjet ne kontakt me keta paciente, me kafshe te infektuara si dhe materialet dhe pajisjet e mjekeve dhe te personelit tjetër, qe kane qene ne kontakt me pacientet e infektuar.

Incinerim dhe asgjesim te mbetjeve spitalore te rrezikshme dhe jo te rrezikshme përfshihen në ato veprimtari që klasifikohen si veprimtari me ndikim të madh në mjedis. PURA-MEDICAL shpk në investimin e saj ka parashikuar që instalimet per incinerimin/asgjesimin e mbetjeve spitalore te jene te kompletuar me të gjitha hallkat teknologjike të nevojshme, sipas të gjitha teknologjive më të përparuara të kohës, në mënyrë që ndikimet mjedisore të jenë brenda niveleve të pranuar nga legjislacioni shqiptar dhe ndërkombëtar.

➤ **Shoqëria PURA-MEDICAL shpk**

Shoqëria PURA-MEDICAL shpk, është krijuar me 15.03.2017 me objekt te veprimtarise ne fushen e Trajtim, sterilizim, asgjesim, inçenerim. Tregtim importeksport mbetjesh spitalore. Grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, perpunim dhe asgjesim i mbetjeve spitalore me Nr. Nipti **L71515507M**.

Qëllimi i instalimeve është incinerimi dhe asgjesimi i mbetjeve te rrezikshme dhe jo te rrezikshme spitalore, duke reduktuar impaktin mjedisore dhe rrezikun e infeksioneve/epidemive qe shkaktohen nga mos trajtimi i i mbetjeve spitalore.

PERSHKRIMI I AUTOKLAVES

Procesi i perpunimit te mbetjeve me metoden e autoklavimit kalon ne keto faza.

- a) Se pari mbetjet grihen ne giresin e pershkruar ne skemen e autoklaves ne menyre qe ato te jene te copezuara perpara procesit te sterilizimit me qellim qe temperatura qe arrihet gjate ketij procesi te mund te deportoje me lehte ne te gjithe sasine qe ndodhet Brenda autoklaves.
- b) Materiali i grire futet ne autoclave e cila eshte e izoluar hermetikisht dhe nepermjet nje dhome uji te brendshme qe ngrohet me rezistenca elektrike te fuqishme duke krijuar avull, arrin qe brenda rreth 60 minutave temperatura ne autoklave te shkoje mbi 135 grade celcius dhe presioni mbi 2.5 bar, kushte ideale sterilizimi, keto te dhena kontrollohen virtualisht nepermjet pultit te komandimit te autoklaves. Jo meshume se 20 minutat pasardhese, i gjithe materiali qe ndodhet ne autoclave eshte teresisht i sterilizuar.
- c) Pas perfundimit te procesit te sterilizimit, autoklaves i jepet komanda stop ne pultin e komandimit dhe i hapet manualisht valvula e presionit qe ndodhet ne pjesen e siperme te saj, ne menyre qe i gjithe avulli i krijuar te kondesohet ne nje nga 2 dhomat cisterne per shkak te ndryshimit te temperatures. Ky process zgjat deri sa temperatura ne brendesi te autoklaves te arrije afersisht temperaturen e ambientit.
- d) Uji i kondesuar ne dhomen cisterne i krijuar ne momentin e kondesimit te avujve te autoklaves, eshte uji i destiluar per shkak se ka kaluar kushtet e destilimit te tij me temperature mbi 100 grade celcius dhe me pas ky uji nepermjet nje pompe rifutet ne dhomen e ujit ne brendesi te autoklaves, per tu riperdorur ne procesin pasardhes.
- e) Ne momentin qe temperatura ne brendesi te autoklaves ka arritur afersisht temperaturin e ambientit dhe presionin normal, behet hapja e deres se autoklaves ne menyre manuale dhe materiali i perftuar pas ketij procesi eshte nga i rrezikshem dhe infektiv ne nje material steril, i cili me pas mund te depozitohet ne landfill.

Kjo metode me autoklave vleresohet si nje metode e zakonshme dhe shume e perdoreshme vitet e fundit ne vende te ndryshme te BE te cilet kane zevendesuar perdorimin e inceneratoreve. Kjo metode eshte perdorur shume vite me pare per te disinfektuar materialet mjekesore per tu riperdorur perseri. Ne ndryshim me inceneratoret kjo metode vepron mbi mbetjet spitalore ne temperature te larta aq sa te srrihet disinfektimi i ketyre mbetjeve sipas llojit dhe infeksioneve qe mund te permbajne, por jo te digjet dhe te emetoj substance ndotese ne ajer siç jane dioksine, furanetj.

Procesi i punes se nje autoklave eshte i thjesht dhe pa emetime ne ajer, avujt e ujit qe prodhohen te kombinuara me lageshti, nxehtesi dhe presion per te eliminuar mikroorganizmat. Ky process eshte perdorur dhe me heret dhe vazhdon te perdoret edhe sot si nje pajisje per te disinfektuar materialet dhe pajisjet spitalore. Ne ditet e sotme kjo metode perdoret per te trajtuar mbetjet bio-spitalore. Shume prej mbetjeve spitalore jane te ndotura nga cdo lloj patogjeni si bakterie, viruse, parasite, etj te cilet i marrin dhe instrumentat qe perdoren. Perdorimi i autoklaves per trajtimin e mbetjeve spitalore eshte vleresuar si metoda me e paster ku pasi trajtohen mbetjet depozitohen ne kuti te mbyllura dhe hermetike apo qese sipas ngjyrave perkatese per tu depozituar ne vendgrumbullimin (lanfillin) e zones perkatese. Autoklava nuk e perzien lenden apo ta rretulloj ate per te mundesuar nderfutjen e avujve te nxehte, pasi kjo arrihet edhe pa u perzier me njeritjetrin, arrihet qe keto mbetje te jene te pidentifikueshme si dhe ulet volumi i tyre rreth 70-80%. Autoklava eshte metodee aprovuar dhe eshte e pranuar nga 50 shtete sin je metode me kosto te ulet ekonomike dhe ambjentale per te trajtuar mbetjet spitalore. Kjo metode vleresohet sot si alternative shume e pershtatshme per trajtimin e mbetjeve spitalore te zonave te vogla locale e cila arrin te trajtoj nga 4 deri ne 400 kg ne dite.

Autoklavimi vleresohet si nje metode e zakonshme dhe shume e perdoreshme vitet e fundit ne vende te ndryshme te BE te cilet kane zevendesuar perdorimin e inceneratoreve. Kjo metode eshte perdorur shume vite me pare per te sterilizuar materialet mjekesore per tu riperdorur perseri. Ne ndryshim me inceneratoret kjo metode vepron mbi mbetjet spitalore ne temperature te larta aq sa te arrihet sterilizimi i ketyre mbetjeve sipas llojit dhe infeksioneve qe mund te permbajne, por jo te digjen dhe te emetoje substance ndotese ne ajer siç jane dioksine, furan etj. Procesi i punes se nje autoklave eshte i thjesht dhe pa emetime ne ajer, avujt e ujit qe prodhohen te kombinuara me lageshti, nxehtesi dhe presion per te eliminuar mikroorganizmat. Ky proces eshte perdorur dhe me heret dhe vazhdon te perdoret edhe sot si nje pajisje per te sterilizuar materialet, mbetjet dhe pajisjet spitalore. Ne ditet e sotme kjo metode perdoret per te trajtuar mbetjet bio-spitalore.

Shume prej mbetjeve spitalore jane te ndotura nga cdo lloj patogjeni si bakterie, viruse, parasite, etj te cilet i marrin dhe instrumentat qe perdoren. Perdorimi i autoklaves per trajtimin e mbetjeve spitalore eshte vleresuar si metoda me e paster ku pasi trajtohen mbetjet depozitohen ne kuti te mbyllura dhe hermetike apo qese sipas ngjyrave perkatese per tu depozituar ne vendgrumbullimin (landfillin) e zones perkatese. Autoklava nuk e perzien lenden apo ta rrotulloj ate per te mundesuar nderfutjen e avujve te nxehte, pasi kjo arrihet edhe pa u perzier me njeri-tjetrin. Autoklava eshte metode e aprovuar dhe eshte e pranuar nga 50 shtete si nje metode me kosto te ulet ekonomike dhe ambjentale per te trajtuar mbetjet spitalore.

Gjate nje procesi kjo autoklave nuk mund te perpunoje dhe sterilizoj nje sasi mbi 1000 kg njehersh sepse per sasi me te larte se 1000 kg, materiali nuk arrin te ekspozohet njetrajtesisht ndaj nxehtesise dhe presionit sipas parametrave te dhomes se sterilizimit. Eshte e rekomandueshme qe dhoma e sterilizimit te mos kryej me shume se 10 procese ne dite per shkak edhe te kohes se nevojshme per ftohjen e saj mbas nje procesi sterilizimi. Kjo metode vleresohet sot si alternative shume e pershtatshme per trajtimin e mbetjeve spitalore te zonave te vogla lokale e cila arrin te trajtoj nga 50 deri ne 10000 kg ne dite. Ky projekt ne vleresim "Asgjesim i mbetjeve spitalore me metoden e trajtimit me presion me avull-autoclaves Model Irop" propozon ndertimin e nje qendre grumbullimi dhe trajtimi te mbetjeve spitalore sipas kategorive perkatese te mbetjeve spitalore sipas kategorive perkatese te mbetjeve qe trajtohen fizikisht me autoclave (metoda presion-avull).

Ky project propozon instalimin e ketij impianti ne Elbasan, ne ambientet e brendshme te nje magazine ekzistuese e cila do te rikonstruktohet dhe do te pajiset me te gjitha instalimet e nevojshme per nje funksionim sa me optimal te kesaj qendre, duke shmangur ne cdo rast ndikimin ne nivele te ndjeshme dhe shqetesuese per komunitetin perreth zones.

Ky project propozon nje nga pese metodat alternative VKM Nr. 798, date 29.09.2010 per miratimin e rregullores "Per administrimin e mbetjeve spitalore" specifikohet ne Shtojcen Nr.3 pika 1, me trajtim fizik (Autoklave-presin-avull).

Avantazhet dhe disavantazhet e Autoklaves

Avantazhet kryesore:

- Mund te trajtoi kategori te ndryshme mbetjesh bio-spitalore
- Nivel i larte i treguesit reduksion i ngarkeses infective te mbetjeve bio-spitalore
- Nuk eshte shkaktar i prodhimit te ndotesve te rrezikshem sic jane dioksinat, furan, gaze te efektit sere
- Prodhon shume me pak ndotes se inceneratori
- Mbetjet spitalore te trajtuar me autoclave mund te depozitohen ne landfillin e mbetjeve urbane dhe per kete subjekti ne fjale ka lidhur nje kontrate me subject te licensusur te cilen do ta gjeni bashkengjitur dokumentacionit ne dosje.
- Autoklava ka nje experience perdorimi shume vjecare ne fushen e mjekesise si dhe ka perdorim te gjere ne SHBA, Canada, Europe etj.
- Eshte nje metode shume koherente dhe miqesore me mjedisin dhe e krahasueshme me kater metodat e tjera.
- Kerkon investime fillestare te ulta

Disavantazhet kryesore:

- Veshtiresisht trajtojne mbetjet qe mund te njihen anatomike
- Nuk trajton mbetjet e tjera tokso-kimike dhe mbetjet radioactive
- Sasi te mbadha te ketyre mbetjeve te lengeta nuk mund te trajtohen ne menyre adekuate ne keto kuto hermetike
- Edera te pakendeshme mund te ndihen gjate procesit te trajtimit
- Mund te shkarkoj VOC
- Kerkon qe te realizohet procesi i seleksionimit te mbetjeve ne qese perkatese me sinjalistiken shoqeruar
- Nuk mund te perdoret per akumulim te nxehtesise

PËRSHKRIMI I STERILIZATOR DHE COPËTUES I INTEGRUAR (ISS) MODEL ISS AC-575

Pajisja Sterilizator dhe Copëtues i Integruar (ISS) model ISS AC-575, kryen si copezimin ashtu edhe sterilizimin me avull te mbetjeve ne nje kontenier te vetem. Kontenieri eshte i pajisur me nje bosht te drejtuar nga motori, me shirita te fuqishem copetimi/shtypes qe zvogelojne madhesine dhe vellimin e mbetjeve.



Zgjidhja kompakte e mbetjeve te rrezikshme mjekesore te Celitron, Stelizator dhe Copetues i Integruar (ISS), eshte nje sterilizues i madh me avull me nje copezues te integruar, i projektuar per shnderrimin ne vend te mbetjeve te rrezikshme ne spitale dhe klinika, duke per bushur rekomandimet e BE-se dhe OBSH-se.

Kontenieri prej celiku inox eshte pajisur me nje bosht te drejtuar nga motori, me shirita te fuqishem copetimi/derrmues qe mund te rrotullohen ne dy drejtime per te zvogeluar madhesine dhe vellimin e mbetjeve ne 20%. Motori

5.5 kW eshte i mjaftueshem per te rrotulluar boshtin me nje RPM 300-1100 per operime tendryshme. Tehet jane montuar ne bosht dhe jane te projektuara per te copetuar mbetje te tilla si mjete te mprehta, diatizues, shiringa, letra, rroba, plastike dhe qelq.



Copetimi eshte i rendesishem pasi rrit depertimin e avullit prandaj permireson rezultatet e pergjithshme te sterilizimit. Avulli prodhohet nga brenda nga nje gjenerator i avullit i furnizuar nga sistemi i pastrimit te ujit dhe kullimit si pajisje shtese. Kontenieri eshte ndertuar me sperkates te brendshem per pastrim automatik. I gjithe procesi eshte automatik, duke perfshire hapjen dhe mbylljen e deres, kthimin dhe rrotullimin e kontenierit dhe sekuencat e copetimit dhe sterilizimit. Koha totale e ciklit mund te zgjase per 25 minuta dhe mund te perpunohen 15-25 kg mbetje. Pasi mbetjet



trajtohen ne pajisjen Sterilizator dhe Copetues i Integruar (ISS) model ISS AC-575, ato jane sterile. Nese mbetjet jane te dehidratuara dhe sterilizuara, nuk ekziston rreziku i gjenerimit te ujerave te ndotura. Mbetjet pas trajtimit jane te fragmenterizuara, jo toksike, kryesisht te ngurta dhe te thata dhe per kete arsye, jane te sigurta per tu klasifikuar si mbetje te ngurta urbane.

Specifikimet e pajisjes Sterilizator dhe Copëtues i Integruar

Modeli ISS		ISS AC-575
Madhesia e dhomes	Distanca	500
	Thellesia	800 mm
Vellimi i dhomes		150 l
Pesha me/pa strehim		880/600 kg
Dimensionet e jashtme me strehim WxHxD		1290 x 2150 x 2039 mm
Dimensionet e jashtme pa strehim WxHxD		900 x 1200 x 1420 mm
Dera e dhomes		Dera automatike me karakteristika te perparuara te sigurise
Temperatura e sterilizimit		134 °C - 138 °C
Burimi i avullit		Gjenerator i integruar rrjedhes (me mundësi të lidhjes me avull të jashtëm)
Presioni i avullit (relative)		3 bar (43.5 psi)
Ajri i ngjeshur		6.0-8.0 bar (87-116 psi)
Burimi i ujit		Uji i filtruar i rubinetit
Presioni i ujit		1.0-6.0 bar (14.5-87 psi)
Furnizimi me energji elektrike		3-Ph. 380-400 V, 50/60 Hz
Me gjenerator avulli		25 kW

Avantazhet e pajisjes

- I lehtë në përdorim - Nuk ka nevojë për kualifikim teknik special.
- Zhurmat mjedisore - Mbetjet e copëtuara reduktohen në sa më shumë sa 1/5 vëllimi i tyre original, pa lëshuar substanca të dëmshme.
- Kosto efektive - Operim dhe mirëmbajtje e lirë.
- Plotësisht i sigurt - Dera e mbylljes automatike ndalon ndërprerjen e paautorizuar.
- Efektive - Një njësi e vetme mund të shërbejë për çdo spital, klinikë ose laborator të madhësisë së mesme.
- Kompakt - Dhoma prej vetëm 3 x 4 metra është e nevojshme.
- Instalohet me lehtësi dhe shpejt - Brenda një dite.

PËRSHKRIMI I INCINERATORIT

Modeli NO: WFS-30~WFS-500, Materiali: Çelik prej çeliku me materiale zjarrdruuese, Ngjyra: Blu/Argjend/Gjelbër/E Zezë, Burimet e shkarkimit: Përpunimi i Mbeturinave të Ngurta, Karburanti: Diesel / LPG / Gaz natyror, Paketa e Transportit: Paketa e Detit Origjina: Kina. Çertifikata e autorizuar: ISO9001; SGS, BV, Patentë Kombëtare, Shkalla e djegies:10~500 kg/Grumbull, Metodat e Përpunimit: Djegie me Gazifikim të Lartë, Përparësia: Nuk ka tym të zi, Trademark: Mirë, Specifikimet: ISO standardi/standardi ndërkombëtar, Kodi HS: 8417809090

Të dhënat për Incineratorin:

Modeli i i incineratorit është	WFS – 30
Kapacitetit në cikël	20-30 kg (realizon 3-6 cikle në ditë)
Dimensioni i inçeneratorit	1.45x0.9x1.75
Dimensioni i furrës	480x600 mm
Pesha e inçeneratorit	2300 kg
Tensioni i paisjes	380 V/ 220V
Kapaciteti trajtues i mbetjeve	30 X 6 = 180 kg/ditë
Konsumi i naftës:	0.11kë 4-6 kg /orë
Diametri i jashtëm i oxhakut	280 mm
Lartësia e oxhakut	1.75 m

WFS Series Incinerator mbeturinash është një lloj makine që është zhvilluar në bazë të teknologjisë japoneze, thith avantazhet e pajisjeve të ngjashme si në shtëpi dhe jashtë vendit. Ajo përmban merita unike dhe të avancuara me madhësi kompakte, efekt të lartë djegieje, teknologji të arsyeshme djegieje, shkallë të lartë jo të dëmtuar etj. Është një zgjedhje ideale për trajtimin e mbeturinave të spitaleve, hoteleve dhe zonave të ndryshme.

Djegia e pirolizës së gazuar përdoret për djegien e shumë llojeve të mbetjeve. Të dyja, të motivuara me gaz dhe të motivuar nga nafta, të gjitha mund të preferohen sipas nevojave të klientëve. Mbetjetet përditshme mund të digjen një herë nga djegia e gazifikuar.

Djegija e gazifikuar, trajtimi i përzjerjes së djegies dhe burnout siguron standarde të ulëta të emetimit të pluhurit, dioksinës etj. (Më e ulët se standardi ndërkombëtar). Operacioni tërësisht i mbyllur është i përshtatshëm për trajtimin e mbetjeve infektive për të shmangur ndotjen sekondare. Struktura kompakte dhe pushtimi i tokës së vogël.

Mbeturinat spitalore mjekësore: Fashë, Letër / Injeksion Shishe me shiringë shishe, barna të skaduara, viskozë infektive etj. Trupi i kafshëve infektive të sëmura/lesh/flokë, të përdorur gjerësisht në kafshët e dëmtuara: derr, qen, mace, peshk, pulë, bagëti, etj.

Mbetjet e përditshme në shtëpi. Mbeturinat plastike të disponueshme. Disa mbetje të tjera industriale.

Shandong Better Mbrojtjen e Mjedisit Teknologjia Co, Ltd, Ajo është ndërmarrja më e madhe e teknologjisë së mbrojtjes së mjedisit në Shandong Province, miratuar teknologjinë e SHBA. Me përvojë mbi 10 vjet në makineri, gjatë dhjetëvjeçarit të kaluar, kemi fituar reputacion shumë të mirë në mesin e klientëve tanë në të gjithë botën, Turqia, Japan, Arabia Saudite, Bangledesh, Irani, Iraku, Vietnami, Singapori, Maldivet, Malajzia, Comlombia, Ekuador, Meksikë, Mongoli, UZ, etj, dhe mori Patentën Kombëtare për këtë produkt. Ne jemi ekspert i industrisë së trajtimit të ujërave të zeza dhembeturinave.

Përshkrimi

Mbushja e mbeturinave mjekësore posedon pronën e vet intelektuale me madhësi kompakte, efikasitet të lartë të djegies, kontroll automatik, teknologji të arsyeshme djegieje, shkallë të lartë jo të dëmtuar etj, është një zgjedhje ideale për trajtimin e mbeturinave të spitalit, hoteleve, stacioneve të ndryshme dhe industrive.

Përparësia

- Jetëgjatësi e gjatë
- Operacioni tërësisht mbyllur
- I përshtatshëm për trajtimin e mbetjeve infektive
- Shmangni ndotjen sekondare
- Funksionim i thjeshtë

Karakteristikat kryesore

- Të dyja, të motivuara nga gazi dhe të motivuara nga nafta, të gjitha mund të preferohen sipas nevojave të klientëve.
- Djegia e gazuar përdoret për djegien e shiringës, mbeturinave të letrës, fashave, pambukutabsorbues dhe mbeturinave të tjera mjekësore.
- Mbetjet e përditshme mund të digjen një herë nga djegia e gazifikuar.
- Djegie e gazifikuar, trajtimi i përzier me djegie dhe burnout siguron një standard të ulëtshkarkimi të pluhurit (më i ulët se standardi ndërkombëtar).
- Operacioni tërësisht i mbyllur është i përshtatshëm për trajtimin e mbetjeve infektive për tëshmangur ndotjen sekondare.

Parimi i funksionimit

Modeli WFS-30 është i bazuar në teknikat më moderne të djegies duke ndare procesin e djegies në dy faza të dallueshme. Hapi i parë lejon volatilizimin dhe gazifikimit të përbërësve të ndryshëm të mbeturinës në një mënyrë të tillë që të marrë një përzierje të gazit të djegshëm me një vlerë kalorike. Kjo fazë e parë e djegies ndodh në dhomën e parë në mungesë të ajrit dhe në temperatura relativisht të ulëta për të kufizuar sa më shumë të jetë e mundur fillimin e një djegies vërtetë.

Faza e dytë konsiston në përcjelljen përzierje gaztë në afterburner dhomës mesme, ku, për shkak të një fluksi të konsiderueshme të ajrit në lëvizje të trazuar dhe me ndërhyrjen e një furrë të mesme e cila mban temperaturën në rreth 850 °C, gazrat djegshme prodhuar nga distilimi i refuzimit është marrë nga djegia e plotë. Gazi oksidohet plotësisht në temperaturë të lartë të përjashtohet direkt në atmosferë nëpërmjet tubit të shkarkimit.

Procesi i djegies në dy faza zbatohet në përputhje të plotë me parametrat minimale operative të dispozitave aktuale të ligjit dhe lejon një kufizim të rëndësishëm të shkarkimeve ndotëse. Në fakt, burimi i substancave të ngurta pezull në gaz ndodh në dhomën kryesore, e cila në këtë rast vepron nën kushtet stekiometrike dhe në një regjim të turbullirave të ulët, duke rezultuar në një përmbajtje të ulët të hirit në gazrat, në dobi të mjedisit dhe pastrimi i tubat e rekuperator dhe efikasitetit të këmbimit ngrohjes.

Pasi mbushet dhoma e djegies fillon ciklin e djegies dhe rimëkëmbjen e njëkohshëm të nxehtesise. Për kohëzgjatjen e ciklit, si për funksionet operative të furrës si dhe të rikuperimit, mbahen nën kontroll nga paneli elektrike dhe instrumentat. Në fund të ciklit të djegies fillon periudha e ftohjes graduale, të kontrolluar nga panel elektrike. Pasi ju drejtuar ftohjes ju mund të shkarkoni hirit dhe skorjet.

Modeli WFS-30 ofron avantazhe të tjera të rëndësishme:

- Pastërtia dhe higjena e mjedisit, sepse mbeturinave mund të futet direkt në dhomën e djegies edhe kur furra është e ndalur.
- Operacionet manuali reduktuar në minimum, të kufizuara të ngarkesës së materialit që do të digjen dhe shkarkimin e mbeturinave.
- Operacion të thjeshtë, të qetë dhe të sigurt në sajë të kontrollit të plotë të kryer nga pajisjet e kontrollit dhe paneli. Ky funksion ju lejon për të vepruar edhe me personel të pakualifikuar.
- Mirëmbajtje minimale nuk ka lëvizje pjesë, djegesit janë klasa standarde komerciale.
- Emetimet e furres së djegies janë pangjyrë, pa erë

Miratimi i një autoloader lejon futjen e mbetjeve edhe dhe furre funksionale me rritjen konsekuent të konsiderueshme në potencialin e përgjithshëm të dispozicionit të ngarkesës dhe asgjësimit. Ngarkues ka avantazhin e në mënyrë efektive të zgjidhur problemet e shkaktuara nga variacioni sezonal në hedhjen e mbeturinave për asgjësim.

Përveç kësaj, autoloaderi (ngarkuesi/transportuesi automatik) kufizon kontaktin e operatorit me mbetjet gjatë ngarkimit, instalimi i saj rekomandohet në të gjitha rastet kur ky kontakt mund të jenë të dëmshme dhe të padëshirueshme në çdo rast operatorit vetë.

Elementet përberes të instalimeve të impiantit janë:

- Dhoma e djegies
- Dera e ngarkimit
- Porta e largimit të hirit
- Brucatori primar
- Dhoma e post-djegies
- Dhoma sekondare
- Ventilator i sistemit të ajrimit të djegesit
- Termoelement për matjen e temperaturës së dhomes primare
- Termoelement për matjen e temperaturës së dhomes sekondare
- Oxhaku
- Kuadri elektrik i komandimit dhe kontrollit të impiantit

Sistemi i modelit WFS-30 është një strukturë vetë-mbështetës si një pjesë që vjen e mbledhur dhe gati për operim. Dhe është e nevojshme, në fakt, për të kryer vetëm pozicionimin e pajisjeve dhe montimin e oxhakut, përveç për të bërë lidhjet për furnizimin me lëndë djegëse dhe energjisë elektrike me kuadrin. Versioni standard përfshin bruçatori primar dhe sekondar i gazoilin.

Persa me sipër Pura-Medical nuk do të bëjë asnjë lloj ndryshimi thelbësor në mënyrën e operimit, teknologjinë e përdorur apo ndryshim në sipërfaqe, ndryshimi i kërkuar do të bëhet vetëm për të shtuar në lejen që disponon disa kode mbetjesh pas trajtimit të cilat janë kërkesë e landfillit që është dhe destinacioni final i këtyre mbetjeve.

Leja që subjekti disponon është për aktivitet si më poshtë: “Menaxhimi i Mbetjeve” ID 5.1 a ID 5.1 c ID 5.3 a

5.1 a) Incinerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incinerimi

5.1 c) Incinerim i mbetjeve duke përfshirë mbetjet e kafsheve në një instalim incinerimi, përveç atij të referuar në pikën 5.1 a.

5.3 a) Asgjесimi i mbetjeve të rrezikshme përveç incinerimit (5.1a) ose landfillit (5.2a)

PURA-MEDICAL SHPK kërkon të shtojë në lejen e Mjedisit Tipi A që disponon kodet e mbetjeve si më poshtë:

19 03 Mbetje të stabilizuara të ngurtësuar

19 03 04* Mbetje të përcaktuara si të rrezikshme, pjesërisht të stabilizuara

19 03 05 Mbetje të stabilizuara të tjera nga ato të përmendura në 19 03 04

19 03 06* Mbetjet e përcaktuara si të rrezikshme, të ngurtësuar

19 03 07 Mbetjet e ngurtësuar, të tjera nga ato të përmendura në 19 03 06

• IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS DHE MASAT PËR MINIMIZIMIN E TYRE

Mjedisi është gjithmone i prekur nga veprimtaritë e ndryshme që ushtrohen në të, por ndikimi mund të jetë i ndryshëm, kjo është e lidhur ngushtë me vetë llojin e veprimtarisë e cila mund të ketë impakt të drejtperdrejtë, të terthortë, të rëndësishëm apo mesatar i pranueshëm.

Një nga objektivat e këtij raporti është identifikimi i ndikimeve të mundshme që mund të shkaktohen në mjedis nga ky aktivitet në teresi. Identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedisin e kësaj zone do të vlerësohen në njëren prej fazave kryesore; faza e operimit, pasi objekti është i ndërtuar dhe ndikimi në mjedis do të jetë vetëm nga funksionimi i pajisjeve dhe makinerive të linjës së incinerimit, asgjесimit dhe transferimit të mbetjeve spitalore. Nuk marrin në konsideratë fazën pas përfundimit të veprimtarisë pasi ky projekt do të vazhdojë të jetë i tillë dhe pas shumë kohësh. Disa prej ndikimeve kryesore që janë vlerësuar si të mundshme janë paraqitur si më poshtë.

b) Impakti në mjedis i këtij impianti dhe menaxhimi i tij

Në vijim do të paraqesim një përmbledhje të efekteve negative mbi mjedisin të cilat lidhen me incinerimin, asgjесimin dhe transferimin e mbetjeve spitalore gjatë fazës operative së bashku me rekomandimet mbi menaxhimin e tyre.

Vlerësimi i rëndësisë të ndikimeve në mjedis të aktivitetit të instalimeve për incinerimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore

Faza	Receptori i ndikimit	Shtrirje fizike madhësia	Kohëzgjatja	Kthyeshmëria	Rëndësia e ishumatore shtrirjes, kohëzgjatja dhe kthyeshmëria	Nevojat për rmasat zbutëse
Toka						
Funksionimi	Gjerimi i hirit nga incinerimi dhe mbetjeve sterile nga autoklava	lokale	gjate gjithë periudhës së funksionimit të instalimit	jo depozitim në lëndë apo incinerim në incineratorin e mbetjeve urbane të Elbasanit	i rëndësishëm	Mbetjet e hirit që gjenerohen nga proceset e incinerimit duhet të grumbullohen, magazinohen në kontener metalik dhe etiketohen, ndërsa mbetjet e gjeneruara nga autoklava grumbullohen dhe magazinohen në kontener plastike.
	Gjenerimi i mbetjeve të gazta, dhe mbetjeve nga oxhaku	lokale	gjate gjithë periudhës së funksionimit të instalimit	po (rikuperim dhe riciklim)	i rëndësishëm	mbetjet e gjeneruara nga trajtimi i gazeve, nderimi i filtrave, pastrimi i oxhakut, do të rikuperohen dhe magazinohen në fucia të mbyllura hermetikisht dhe do të realizohet asgjësimi i tyre nga

						subjekte te licencuara
Biodiversitet						
funksionimi	Shqetësim i faunës së zonës	Lokale	Përkoshëm	Po	I rëndësishëm	Instalimet ndodhen brenda objektit dhe janë te pajisur me pajisje mbrojtëse ndaj zhurmes, duke mos patur ndikim ne faunen e zones perreth, edhe pse eshte zone e varfer me gjallesa
Ujerat						
funksionimi	Gjenerimi i ujrave teknologjike	Lokale	gjate gjithe periudhes se funksionimit te instalimit	po (grumbulli mdhe trajtim)	I rendesishem	Gjate procesit te pastrimeve industrial te autoklaves dhe incineratorit, keto ujera grumbullohen dhe kalojne ne vasken e dekantimit, ku trajtohen perpara shkarkimit te tyre ne rrjetin e kanalizimeve
Ajer						
Funksionimi	Gjenerimi gazrave	Lokale	I përkoshëm	Po	I rëndësishëm	Nga proceset e incinerimit te mbetjeve spitalore kemi gjenerim te gazrave te demshem ne atmosfere, ku shoqeria ka marre te gjitha masat e

						nevojshme per kapjen dhe trajtimin e tyre. Fillimisht behet e mundur ulja e temperatures se gazeve me qellim eliminimin e gazeve sere, me pas nepermjet impiatit te trajtimit te gazeve behet emundur reduktimi i shkarkimeve ne ajer.
--	--	--	--	--	--	--

MASAT ZBUTESE TE PROJEKTUARA TE NDIKIMEVE NEGATIVE GJATE PROCESIT TE FUNKSIONIMIT

Masat zbutëse të ndikimeve negative konsistojnë në marrjen e masave për uljen e ndotjeve gjatë funksionimit të instalimit në ajër, si gazrat dhe zhurma, si dhe ujrat teknologjike të ftohjes, menaxhimi i mbetjeve, uljen e efekteve negative hapsinore në territor, faun dhe florë. Por pikësynimi i studimit mbetet menaxhimi i linjës së incinerimit/asgjesimit të mbetjeve spitalore dhe evitimi në maksimum i clirimit të gazrave në ajer dhe ujrave teknologjik.

Identifikimi i masave për të eleminuar apo zbutur ndikimet negative në mjedis

- Planifikimi i zones së instalimit

Për shmangien dhe parandalimin e gjenerimit të gazrave, ujrave, mbetjeve dhe zhurmave, si dhe për ruajtjen e regjimit të linjës së incinerimit/asgjesimit dhe prametrave inxhiniero mekanike të saj, në projekt është përcaktuar funksionimi harmonik dhe i kombinuar në kohë dhe hapësirë i objektit në tërësi dhe i linjës së asgjesimit, icinerimit dhe transferimit të mbetjeve spitalore.

Në objektin ku ndodhet instalimi është parashikuar hapa pas hapi, rigjenerimi i mjedisit të brendshëm e të jashtëm, sistemimi i lëndës së pare (mbetjeve spitalore), parkimi i automjeteve, magazinimi i pajisjeve/makinerive ndihmese dhe ngarkimi mbetjes të prodhuar nga incinerimi apo asgjesimi, duke realizuar shfrytëzimin sa më eficient të mjedisit të shfrytëzuar dhe lendes se pare ngashoqëria “PURA-MEDICAL” Sh.p.k

MASAT E PROPOZUARA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT NGA SECILI NDIKIM NEGATIV

Rekomandime për zbutjen e ndikimeve
Toka

Përdorimi i Tokës	Kryerja e aktivitetit brënda koordinatave dhënë në relacion. Rrespektimi i kushteve teknike dhe standarteve.
Erozioni	
Mbrojtja nga erozioni	Zbatimi rigoroz i masave teknike për operimin e linjës së impiantit të incinerimit dhe asgjesimit. Pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujrave të shiut dhe ujrave teknologjike. Mbjellja e fidanëve përreth perimetrit të objektit në përdorim, me qëllim mbrojtjen e kompaktësisë së tokës. Mirembajtja e bazamentit ku janë të instaluar linja e incineratorit dhe autoklaves.
Biodiversiteti	
Vegjetacioni Dëmtim potencial i vegjetacionit	Mirëmbajtja e kurorës së pemëve dhe bimësisë së mjedisit në përdorim nga shoqëria. Mbjellja e fidaneve të rinj, përgjatë rrugës që ben të mundur hyrjen për në objekt.
Cilësia e ajrit	
Rritje e emetimeve në ajër nga funksionimi i linjës së incinerimit/autoklaves dhe djegia e karburantit të automjeteve ngarkim-shkarkimit	Mirembajtja e linjës së incinerimit/autoklaves dhe ndërrimi periodik i filtrave sipas kapacitetit mbajtes. Mjete me kolaudim optimal. Pjesë këmbimi rezerve brënda objektit për raste emergjente. Plan veprimi në rast rrjedhjesh. Përdorimi eficient i mjeteve motorrike. Përdorim i karburantit cilësor. Pastrim periodik i objektit të zonës në shfrytëzim dhe mjeteve të punës. Pastrimi periodik i linjës së incinerimit/asgjesimit, duke mbarëvajtur operimin optimal të tij. Përdorimi i lëndës djegëse me përmbajtje squfuri të ulët sipas kërkesave të legjislacionit shqiptar mjedisor (përmbajtja e S < 1 %);
Sistemi I drenazhimit	
Sistemi i drenazhimit	Mirembajtja e sistemit të drenazhimit të ujrave të shiut dhe ujrave teknologjike të pastrimit përgjatë gjithë gjatësisë së objektit, bashkimi i tyre në një vaske dekantimi të përbashkët dhe me pas shkarkimi i tyre në rrjetin e kanalizimeve të zonës brenda normave të lejuara. Trajtimi i ujrave teknologjike sipas rastit dhe shkarkimin e tyre në mjediset ujore pritese brenda normave të lejuara.
Mbetjet	

<p>Shtim i mbetjeve teknologjike dhe urbane nga aktiviteti human i punonjësve që do të operojnë në objekt.</p>	<p>Vendosja e kontenierëve në brendësi dhe jashtë objektit, diferencimi i mbetjeve sipas fraksioneve të gjeneruara dhe transportimi periodik i tyre në vende deponimit më të afërt të caktuar nga njësia vendore.</p> <p>Grumbullimi, Etiketimi dhe Asgjesimi i mbetjeve që vijnë nga impianti i incineratorit dhe autoklave, nga kompani të licensuara (Shoqeria ALBTEK ENERGY.</p> <p>Monitorim dhe inspektim i vazhduar në vendin e deponimit.</p> <p>Në rast nevojë, të merren veprime të posaçme</p>
<p>Zhurmat</p>	
<p>Rritje e nivelit të zhurmavenga impianti/instalimet dhe nga lëvizja e automjeteve</p>	<p>Përdorimi i mjeteve të kolauduara. Përdorim i linjës së incinerimit/asgjesimit brenda orareve të caktuara, nga rregullorja e punës.</p> <p>Përdorimi i mjeteve mbrojtëse nga punonjësit (kufje për mbrojtjen e aparatit të dëgjimit).</p> <p>Përdorimi i mjeteve të punës dhe të transportit gjat orareve të përshtatshme.</p>
<p>Trafiku rrugor</p>	
<p>Trafiku Rrugor Rritje e fluksit të qarkullimit të automjeteve</p>	<p>Lëvizshmëria do të studiohet të kryhet në oraret kushmanget piku i trafikut. Mjetet e transportit do të levizin brenda normave të lejuara të shpejtësisë, referuar Kodit Shqiptar Rrugor.</p>

- Ndjekja e gjithë kërkesave ligjore për veninë në funksion të aktivitetit duke mbajtur parasysh kufizimet dhe detyrimet kundrejt shtetit dhe paleve të treta.
- Aktiviteti kryesisht do të zhvillohet në ambjent të mbyllur kështu që nuk do të ketë nivele zhurmash domethënëse për zonën përreth. Do të bëhet pajisja e punonjësve me mjete mbrojtëse personale, zona ku është pozicionuar aktiviteti është zonë industriale.
- Kompania ka ndërtuar sistemin për ripërdorimin e ujërave të ftohjes dhe krijimin e një cikli të mbyllur.
- Nga ky aktivitet nuk parashikohen të ketë ndikime në ndryshimin e habitateve
- Grumbullim dhe asgjesim përfundimtar nga subjekte të licensuara të mbetjeve të rrezikshme që gjenerohen në fund të procesit të incinerimit dhe asgjesimit të mbetjeve spitalore.
- Mbetjet e gjeneruara nga punonjësit do të grumbullohen në kazan të vecantë. Kazanet do të zbrazen rregullisht dhe mbetjet do të hidhen në vendin e përcaktuar nga Njësia Vendore Bradashesh për mbetjet urbane.
- Do të ndiqen gjithë rregullat e sigurimit teknik në punë si dhe pajisjes së punonjësve me uniformat dhe mjetet e nevojshme të mbrojtjes në punë.

Per me teper rekomandimet per te parandaluar dhe kontrolluar rrezikun e ndotjes perfshijme:

- Mbetjet urbane te grumbullohen transportohen dhe depozitohen ne oraret e caktuara nga Njesia Vendore.
- Te realizohet ndricimi perreth (vendosja e impiantit te ndricimit).
- Te kryhet rregullimi i territorit ne perputhje me kondicionet urbane te percaktuara.
- Shoqeria te operoje ne perputhje te plote me normat qe jane ne fuqi, dhe te kryej monitorime te vazhdueshme te tregueseve mjedisor te trysnise ne mjedis.
- Te respektoje te gjitha rregullat e mbrojtjes kundra zjarrit gjate operimit ne ndertese dhe terespektoje rregulloren e MKZ.
- Te instalohen dhe te respektohen sinjalistikat e trafikut te cilat do te minimizonin impakti peraksidente te mundshme.
- Per te minimizuar impaktin ndaj zhurmave dhe vibrimeve, te limitohen proceset e zhurmshme gjate oreve me te ndjeshme.
- Te respektoje te gjitha masat e percaktuara ne kete Formular Kerkese per ndryshimin e kushtevete Lejes se Mjedisit Tipi A.
- Te respektoje te gjitha kushtet dhe masat qe do te vendosen nga AKM-ja dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Nga vleresimet e mesiperme, shkarkimet e prishme ne mjedis jane te uleta dhe nuk perbejne problem serioz per mjedisin. Megjithatë perparimet qe ka ky aktivitet, duhet te tregohet kujdes ne menaxhimin dhe mbajtjen nen kontroll te kushteve teknike per te minimizuar humbjet aksidentale ose shkarkimet.

Masat qe duhen konsideruar per te minimizuar ndikimin ne mjedis jane:

- Parandalimi i shkarkimeve te gazeve te demshem ne mjedis.
- Parandalimi i shkarkimeve te mbetjeve spitalore ne mjedis, administrimi sipas rregulloreve perkatese.
- Lidhur me mbetjet e gjeneruara nga procesi i incinerimit dhe sterilizimit te mbetjeve spitalore te menaxhohen ne bashkepunim me subjekte te licensuara per riciklimin e metejshem te tyre.
- Sasia depozituese te mos i kaloje volumet e parashikuara ne menyre qe situata te jete e kontrollueshme dhe te mos demtojte instalimin.
- Te zbatohet projekti i mbrojtjes nga zjarri ne menyre qe te perballoje siperfaqen ne rastet e avarive te ndryshme.
- Punonjesit te jene te trajnuar paraprakisht dhe te jene vazhdimisht ne mbikqyrjen e drejtuesit teknik gjate proceseve te punes. Punimet e mirembajtjes te kryhen ne perputhje me kushtet teknike te punes.
- Te mirembahet brezi i pemeve pergjate murit rrethues te prones, ne menyre qe te reduktoje impaktin ne peizazh.
- Te behet sperkatja e sheshit gjate muajve Qershor-Tetor me qellim reduktimin e grimcave te pluhurit ne ajer.
- Te behet kapja dhe trajtimi i gazrave te gjeneruara nga instalimet per incinerimin e mbetjeve spitalore
- Mbetjet e rrezikshme te rikuperohen, depozitohen ne vendin e percaktuar nga drejtuesi

teknik i punimeve me lejen e organeve kompetente dhe te asgjesohen nga subjekte te licencuara.

Masat zbutese te projektuara per minimizimin e ndikimeve negative gjate fazes se funksionimit

Masat zbutëse të ndikimeve negative konsistojnë në marrjen e masave për uljen e ndotjeve gjatë funksionimit të instalimit në ajër, si gazrat dhe zhurma, si dhe ujrat teknologjike të ftohjes të autoklaves, menaxhimi i mbetjeve, uljen e efekteve negative hapsinore në territor, faun dhe florë. Por pikësynimi i studimit mbetet menaxhimi i linjës së incinerimit/asgjësimit dhe evitimi në maksimum i klirimit të gazrave në ajër dhe ujrave teknologjik.

• Plani i Përballimit të Emergjencave

Shoqëria **“PURA-MEDICAL” Sh.p.k** në veprimtarinë e saj, për aktivitetin “Incinerim dhe asgjësim të mbetjeve spitalore”, detyrohet të planifikojë, të organizojë dhe të realizojë me shpenzimet e veta dhe të shtetit shërbimet për përballimin e emergjencave civile në zonën ku zhvillohet veprimtaria.

Shoqëria ka për detyrë:

- Të hartojë plane për situatat e emergjencës civile dhe të zbatojë masat parandaluese në zonën e tyre të veprimtarisë.
- Të hartojë planin e menaxhimit të mbetjeve spitalore, brenda objektit ku zhvillohet veprimtaria
- Të njoftojë personelin si dhe autoritetet e Njësise Bashkiake Vendore për një rrezik imediat.
- Të organizojë, kur është e nevojshme, evakuimin e të punësuarve të tyre dhe të venë në veprim shërbimin e tyre në përgjigje të një situatë emergjence në zonën e tyre të veprimtarisë.
- Të nderhyjë në mënyrë të menjehershme në rast të dukurive natyrore apo emergjencave
- Të sigurojë trajnimin për të punësuarit.

Prodhuesit e mbetjeve kanë detyrën për kujdes për të marrë masat e mëposhtme në administrimin e mbetjeve spitalore të gjeneruara nga objektet e tyre:

- Ndarja që në burim e mbetjeve spitalore nga rrymat e tjera të mbetjeve dhe parandalimi i hyrjes së mbetjeve spitalore në zinxhirin e asgjësimit të mbetjeve të ngurta urbane;
- Ambalazhimi dhe etiketimi siç duhet i mbetjeve spitalore për të mundësuar identifikimin e lehtë, duke përfshirë dhe informacionin mbi burimin e gjenerimit;
- Sigurimi i zonave për magazinimin e përkohshëm të sigurt dhe të siguruar të mbetjeve spitalore;
- Sigurimi që personeli i tyre të marrë të gjitha masat e nevojshme të sigurisë në trajtimin e mbetjeve spitalore, dhe sigurimi i trajnimit të mjaftueshëm për ta; dhe
- Përpilimi i një Plani Administrimi të mbetjeve spitalore për referencë nga personeli i tyre.

❖ **Plani i Menaxhimit të Mbetjeve**

Aktiviteti që zhvillon shoqëria "PURA-MEDICAL", në **Ish Reparti i Kipit të Furnaltes, Kombinati Metalurgjik Elbasan, Elbasan** nga proceset e ndryshme të operimit të punës në objekt për incinerimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore gjenerohet një sasi mbetjesh sa 25% i volumit total të mbetjeve që asgjësohen.

- Kerkesat për administrimin e mbetjeve spitalore
 - a) Të lejohet hyrja vetëm e personave që kanë kualifikim për të administruar mbetje spitalore.
 - b) Të tregohet kujdes për sigurinë e kontejnerëve, të parandalohen rrjedhjet, të sigurohet mbrojtja nga uji, shiu dhe era, si dhe të shmangen kushtet e inkubimit mikrobik dhe/ose të dekompozimit të tyre. Mbetjet njerëzore, shtazore apo të ndonjë gjallesë tjetër të magazinuara për më shumë se 24 orë, por gjithsesi më pak se 48 orë nga ambalazhimi, duhet të ruhen në frigorifer ose hapësirë frigoriferike që përdoret vetëm për mbetjet spitalore në një temperaturë jo më të lartë se 10°C.
 - c) Të jenë ndërtuar me materiale të qëndrueshme dhe pa kënde, që pastrohen lehtësisht, që nuk lejojnë depërtimin e lëngjeve dhe të jenë rezistentë ndaj parazitëve e agjentëve të tjerë mjedisorë.
 - d) Të mbahen pastër në kushte të mira sanitare dhe në gjendje të mirë funksionale.
 - e) Mbetjet të jenë të etiketuara në mënyrë të dukshme me simbolin ndërkombëtar të biorrezikshmërisë të paraqitur në shtojcën 2.A dhe me njoftime të rrezikut në dyer, porta ose mbulesa, frigoriferë dhe kontejnerë të tjerë që tregojnë përdorimin e magazinës për mbetje spitalore, ku hyrja e personave të paautorizuar është e ndaluar.
 - f) Sistemet e kullimit të dyshemesë së magazinës duhet të mundësojnë shkarkimet direkt në një sistem kanalizimesh sanitare për asgjësimin e ujërave të ndotura
- Kontejnerët e mbetjeve të rrezikshme spitalore duhet të përmbushin kërkesat e përcaktuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, të etiketohen në përputhje me shtojcën 2.B dhe të magazinohen në mënyrë të tillë që të lejojnë hyrjen për qëllime inspektimi.

Mbetjet spitalore nuk duhet të presohen apo t'u nënshtrohen veprimeve të sforcuara mekanike, përveç rasteve kur këto janë pjesë e një procesi të posaçëm trajtimi

- Magazinimi i mbetjeve spitalore. Mbetjet infektive nuk duhet të magazinohen për më shumë se

45 ditë para trajtimit. Në qoftë se era përbën shqetësim publik, Inspektorati Sanitar Shtetëror/Inspektorati i Mjedisit kërkon largim më të shpeshtë. Në zonën e magazinimit të kontejnerëve me mbetje mjekësore duhet të ndalohet hyrja e personave të paautorizuar. Zonate magazinimit duhet të kenë shenja paralajmëruese në dyert hyrëse, porta ose kapakë. Në zonën e magazinimit nuk duhet të lejohet hyrja e kafshëve dhe elementeve natyrore dhe të parandalohet krijimi i vendeve të shumimit ose burimit të ushqimit për brejtësit ose insektet. Ato, gjithashtu, duhet të jenë të rrethuara.

- Impianti duhet të mbajë regjistrime të pranimeve, që minimalisht përfshijnë informacionin emëposhtëm:
 - a) emrin dhe adresën e prodhuesit;
 - b) peshën e mbetjeve të pranuar;
 - c) datën dhe orën e pranimin të mbetjeve; dhe
 - d) nënshkrimin e personit që pranon mbetjet.
- Të gjitha regjistrimet që bëhen sipas kësaj rregulloreje, ruhen për një periudhë deri në shtatëvjet



Etiketa e kontejnitorëve

Etiketa përfshin shenjën ndërkombëtare dalluese të rrezikut të mbetjes mjekësore, njoftimin e rrezikut mjekësor në shqip dhe në anglisht dhe numrin e parë të klasifikimit ndërkombëtar (6).

Madhësia minimale e etiketës duhet të jetë 14cm x 14cm dhe të ketë formën e një rombi.




Etiketa që duhet të vendoset në pjesën e prapme të koshit

Etiketa përfshin shenjën dalluese të rrezikut të mbetjes mjekësore ndërkombëtare, njoftimin e rrezikut të mbetjes mjekësore në shqip dhe anglisht, dhe numrin e parë të klasifikimit ndërkombëtar (6). Madhësia minimale e etiketës duhet të jetë 14cm x 14cm dhe të ketë formën e një rombi.

Etiketa që duhet të vendoset në pjesën e përparme të koshit

Etiketa dalluese duhet të përcaktojë me germa të mëdha llojin e mbetjes së rrezikshme, përshkrimin shtesë me germa të vogla dhe duhet të mbajë shenjën dalluese të rrezikut. Madhësia minimale e etiketës duhet të jetë (gjerësi x lartësi) 14cm x 5cm. Etiketa duhet të jetë shkruar në gjuhën shqipe dhe angleze.



Etiketa përshkruese përfshin:

- përshkrimin dhe identifikimin (me germa të bardha në një sfond të zi), “Mbetje spitalore”N.O.S.

Mbetjet mjeksore N.O.S MEDICAL WASTE N.O.S		I Infektuese Infectious
Fjala sinjalizuese: Signalword:	RREZIK DANGER	
Shprehja e rrezikshmerise: Hazard Statement:	mund të shkaktoje infektion may cause infection	
Nr. i UNi/ UN - Number:	3291	
Klasa / Class:	6.2	
Katalogu i Mbetjeve: Waste Catalogue:	18.01.03*	
Nr. i EINECSi/ EINECS Nr.:	
R – Frasa / R - Phrase:	R21	
S – Frasa / S - Phrase:	S1/4/24/35/36/37/43/60	
Shprehja parandaluese / Precautionary Statement:		
Identiteti i furnizuesit / Supplier Identification:		
Personi i Kontaktit / Contact Person:		
Adresa / Address:		
Numri i Telefonit / Tel Number:		

- përcaktimin – “I – infektuese”
- fjalën sinjalizuese “RREZIK”
- njoftimin e rrezikshmërisë “Mund të shkaktojë infektion”
- Numri i OKB-së “3291”1
- Klasën e rrezikut “6.2”
- Numrin e Katalogut Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve “18.01.03*”
- Numrat EINECS 2
- Shprehja e rrezikut “R21”
- Shprehja e sigurisë “S1/4/24/35/36/37/43/60”
- Deklaratë paralajmëruese
- Identifikimi i furnizuesit
- Personi i kontaktit
- Adresa
- Numri i telefonit dhe celularit

- Madhësia minimale duhet të jetë (gjerësi x lartësi) 21cm x 14cm (A5). Etiketa duhet të jetëshkruar në gjuhën shqipe dhe angleze.

Etiketa e “Destinacionit dhe e Deklarimeve”

Çdo kosh i ambalazhuar, i mbyllur dhe vulosur, duhet të identifikohet me një etiketë që duhet të vendoset në unazën e vulës dhe që tregon:

- Vendndodhjen;
- Gjendjen e ngurtë ose të lëngët;

Qendra e Menaxhimit të Mbetjeve e Rrezikshme LOKATION.....			
Te ngurta	<input type="checkbox"/>	Te lëngshme	<input type="checkbox"/>
Bateri	<input type="checkbox"/>	Vaji	<input type="checkbox"/>
Bateri	<input type="checkbox"/>	pendonur	<input type="checkbox"/>
Makinash	<input type="checkbox"/>	Acid	<input type="checkbox"/>
FIBer	<input type="checkbox"/>	Alkali	<input type="checkbox"/>
Pesticide	<input type="checkbox"/>	Pesticide	<input type="checkbox"/>
Kimikate	<input type="checkbox"/>	Kimikate	<input type="checkbox"/>
PleH	<input type="checkbox"/>	PleH	<input type="checkbox"/>
Numri i Kazaneve:		Pesha:kg / litra	
Data e grumbullimit:		Kontrollimi i kualitetit:	
.....		

- Llojin e mbetjes së rrezikshme;
- Datën e grumbullimit;
- Numrin e koshit ose ambalazhimit;
- Sasinë në kg ose litra;
- Nënshkrimin e punonjësit të grumbullimit.

KUSHTET QË DUHET TË RESPEKTOJË TRANSPORTIMI I MBETJEVE SPITALORE INFEKTUESE

Përveç automjeteve të urgjencës që kthehen nga vende aksidentesh, çdo automjet që transporton mbetje spitalore infektuese duhet të jetë lehtësisht i identifikueshëm gjatë transportimit të mbetjeve me shenjën dalluese ndërkombëtare të rrezikut të mbetjes mjekësore dhe fjalët e përshkruara në shtojcën 2.

Automjetet e përdorura për transportin e mbetjeve spitalore infektuese:

- Duhet të përfshijnë një pjesë ngarkues–transportues, që rri e mbyllur dhe e siguruar përveçse kur ngarkon ose shkarkon mbetje spitalore për të parandaluar hyrjen dhe ekspozimin e paautorizuar ndaj erës dhe reshjeve.
- Duhet të jenë projektuar dhe ndërtuar në mënyre të tillë që të mos lejojë derdhjet;
- Duhet të jenë pastruar dhe dizinfektuar pas rrjedhjeve ose derdhjeve aksidentale;
- Duhet të jenë pastruar dhe dizinfektuar para përdorimit për ndonjë qëllim tjetër; dhe
- Nuk duhen përdorur për të transportuar ushqime, produkte ushqimore, kontejnerë ushqimorë ose ndonjë substancë, e cila do të gjëllitet nga njerëzit ose kafshët ose do t'i shtohet ushqimeve të njerëzve ose kafshëve.

Gjatë transportimit të mbetjeve spitalore infektuese, automjetet duhet të mbajnë më vete një kitpër ndalimin e derdhjeve dhe për pastrimin e automjetit.

Çdo derdhje prej njëzet (20) ose më shume kilogramësh, duhet të raportohet sa më shpejt që të jetë e mundur te punëdhënësi, Inspektorati Sanitar Shtetëror, Inspektorati Mjedisor, sikurse dhe tek organi kompetent i qeverisjes vendore. Çdo kontakt direkt i mjetit ose pajisjes me mbetjen spitalore duhet të konsiderohet dhe trajtohet si derdhje.

STANDARDE TEKNIKE PËR INCENERIMIN DHE AUTOKLAVIMIN E MBETJEVE SPITALORE

Procesi i sterilizimit nëpërmjet autoklavimit duhet të përfshijë në të njëjtin moment procesin e reduktimit volumor dhe të sterilizimit të mbetjeve spitalore. Sterilizimi duhet të bëhet me avull në temperaturën jo më të vogël se 130°C dhe në presionin jo më të vogël se 1.1 bar.

Qëllimi i menaxhimit të mbetjeve: Incinerimi dhe Asgjësimi i mbetjeve spitalore ka për synim trajtimin e tyre dhe sterilizimin, duke ulur ndjeshëm mundësinë e shfaqjes së sëmundjeve infektive nga keq menaxhimi i këtyre mbetjeve që gjenerohen nga spitalet.

Menaxhimi i mbetjeve brenda zonës së instalimit është tërësisht i bazuar në SKMM, PKMM, PRMM dhe Rregulloren “Per administrimin e mbetjeve spitalore”.